

-43

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETARE I UJIT**  
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

---

**V E N D I M**

Nr. 2      Date 06.04.2010

“PER  
MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TE POSACEM  
PER PERDORIM TE REZERVES UJORE  
PER PRODHIM HIDROENERGJIE.

Bazuar ne piken 9, kreu XI, “Shpallja e fituesit dhe negociimi i kontrates”, i vendimit nr. 87, dt. 16.01.2008 te K.M. “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M.”, “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, dhe nenit 18 germa dh, te ligjit nr.8093 dt. 21.06.1996 “Per rezervat ujore”, me propozim te A.U.B. Drin-Bune, Keshilli i Basenit Ujembledhes Drin-Bune :

**V E N D O S I :**

- 1- MIRATIMIN e Autorizimit te posacem per Perdorim te Rezerves Ujore te Lumit Leproit, komuna Shemri, rrethi Kukes, per HEC Shemri dhe Mgulle, per prodhim hidroenergjie, bashkimit te perkohshem te shoqerive “Oberaldi”sh.p.k. dhe “Lala”sh.p.k. te cilet kane nenshkruar Kontraten e Koncesionit me autoritetin kontraktues me date 16.06.2009, bazuar ne miratimin e marre ne V.K.M.nr.1300 dt. 24.09.2008, mbasi subjekti ka depozituar prane A.U.B. Drin-Bune kerkesen dhe kopjen e Kontrates se Koncesionit per HEC-et qe do te ndertoje.
- 2- Perdorimi i rezerves ujore per prodhim hidroenergjie jepet me kusht qe te mos kufizohet furnizimi me uje te pijshem dhe nevojave te bujqesise ne zone.
- 3- Tarifa per leshimin e lejes do te behet sipas pikes 3 te vendimit nr. 13 dt. 09.08.2006 te K.B.U. Drin-Bune.
- 4- Ngarkohet A.U.B. Drin-Bune per zbatimin e ketij vendimi.

**PERGJEGJESI I A.U.B.**

**DRIN-BUNE**

**Xhelal BAJRAKTARI**



**KRYETARI I K.B.U.**

**DRIN-BUNE**

**Maxhid CUNGU**

